



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 13.08.2025
Numër Protokolli: 5466/2025

A.nr.788/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.788/2025, të datës 02.05.2025 të parashtruar nga ankuesi N.G kundër organit të punësimit: Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*transferim pas rristurimit*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 13.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.788/2025 të datës 02.05.2025, të parashtruar nga ankuesi N.G.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, N.G (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), më datë 28.04.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit MMPHI-336/2025 dhe numër protokolli 587 të datës 18.03.2025 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB, lidhur me transferimin pas rristurimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli), bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ndërsa kjo e fundit më datë 26.05.2025, ka dorëzuar përgjigjet në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Tutje, Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së Kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me Vendim me numër protokolli 4018/2025, të datës 13.06.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.788/2025, të parashtruar nga ankuesi edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: *Kolegji i Këshillit*) pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë konstatoi procedura e iniciuar sipas ankesës A.nr.788/2025, duhet të përfundohet në kuptim të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, gjegjësisht sipas Akt emërimit të datës 19.05.2017, i njëjti mbanë pozitën e punës *Udhëheqës i Divizionit për Zhvillimin e Politikave dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare në Transportin Tokësor*, në Departamentin e Transportit Tokësor.

Tutje sipas Vendimit me Nr.073/2024 të datës 29.03.2024 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, është miratuar Rregullorja (ZKM) Nr.08/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ndërsa në kuadër të përgjegjësiave ligjore, Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme me Vendimin me Nr.2392/2024, të datës 29.11.2024, ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për Ministrinë e Mjedisit, Planifikimi Hapësinor dhe Infrastrukturës, i cili më datë 03.03.2025 ka miratuar Raportin e punës me Nr.191, dhe propozimet lidhur me ristrukturimin për këtë institucion, duke propozuar që ankuesi të transferohet nga pozita *Udhëheqës i Divizionit për Zhvillimin e Politikave dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare në Transportin Tokësor*, në pozitën *Udhëheqës i Divizionit për Transport Ujor*.

Si rrjedhojë, Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më datë 18.03.2025 ka nxjerr Vendimin MMPHI-336/2025 dhe numër protokolli 587, për transferimin e nëpunësit civil për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, me të cilin akt ankuesin nga pozita aktuale e ka transferuar në pozitën *Udhëheqës i Divizionit për Transport Ujor* në Departamentin e Transportit të Përgjithshëm..

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon se procesi i Vlerësimit për Klasifikimin e Vendeve të Punës dhe Ristrukturimit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, që nga fillimi e deri në përfundimin e është përcjell me shumë parregullsi dhe shkelje ligjore, si në aspektin procedural dhe po ashtu material, andaj kërkon aprovimin e ankesës, anulimin e Vendimit MMPHI-336/2025 dhe numër protokolli 587 të datës 18.03.2025, me obligimin që DMZP dhe MMPHI ta caktojnë të njëjtin në njërin nga këto pozita: Udhëheqës i Divizionit të Lejeve dhe Licencave të Transportit, Udhëheqës i Divizionit të Transportit Rrugor apo në pozitën Udhëheqës i Divizionit të Transportit Hekurudhor, pasi që të gjitha këto pozita janë derivat i Departamentit të Transportit Tokësor.

Duke qenë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kishte pranuar disa ankesa të nëpunësve civilë të pakënaqur me procesin e ristrukturimit në MMPHI, ashtu që Këshilli me Vendimin me numër A.nr.786/2025, të datës 11.08.2025, ka aprovuar ankesën e datës 30.04.2025, të parashtruar nga të ankuesi B.T, duke shfuqizuar Raportin Përfundimtar të Komisionit të Ristrukturimit në MMPHI të datës 03.03.2025 dhe të gjitha vendimet dhe procedurat që rrjedhin nga ky raport.

Andaj, referuar gjendjes faktike si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.788/2025, të datës 02.05.2025, ka të bëjë me vendimin për transferim për shkak të ristrukturimit, vendim ky, i pasuar si veprim nga zbatimi i Raportit Përfundimtar të Komisionit të Ristrukturimit në MMPHI të datës 03.03.2025, e duke qenë se ky akt është shfuqizuar si i paligjshëm me Vendimin A.nr.786/2025, të datës 11.08.2025 të KPMSHCK-së, atëherë, mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: “Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik

kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot". Kolegji vlerëson se objekti i ankesës A.nr.788/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.788/2025, të datës 02.05.2025.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.788/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit N.G;
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në MPB;
- Njësisë për Burime Njerëzore në MMPHI; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.